




Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

GRUAJA NË FOKUS

Gazetë e ilustruar, Nr. 5, Prizren, 2014





Mybexhel Zhuri,
Koordinator e NJDNJ, Prizren



Jubilea Kabashi, Qendra për
Strehimin e Grave dhe Fëmijëve



Ajshe Shala, Asambleiste
e Kuvendit Komunal, Prizren



Nga e majta në të djathtë: Šehida Miftari dhe Flutura Hoxha,
Qendra Rajonale e OSBE-së, Prizren



Prezantimi i projektit “Iniciativa për zhvillimin dhe avancimin e femrave-Arti gjuhë e përbashkët”
të OJQ-së “Femra për Femrat me Aftësi të Kufizuar”, financuar nga Agjensioni për Barazi Gjinore, Prishtinë

PËRMBAJTJA:

3	Editorial
4-5	Mybexhel Zhuri, Plani i Veprimit i Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut në Prizren për periudhën janar-qershor 2014
6	Aktivitetet e Zyres së NJDNJ-së dhe të Barazisë Gjimore të Kuvendit Komunal të Prizrenit me OJQ-të e qytetit
7	Manifestime
8	Intervista e Gazetës
9	Pyetësori i Gazetës
10-11	Rregullorja e Grupit Joformal të Grave të Prizrenit
12-13	Aktivitetet e Grupit Joformal të Grave të Prizrenit
14	Ndihmo sot për një të ardhme më të mirë të grave dhe vajzave
15-18	Ilustrime
19	Drita Vukshinaj, Aktivitetet e OJQ-së “Femra për Femrat me Aftësi të Kufizuara”, Prizren
20-21	Përmirësimi i shëndetit të grave dhe vajzave dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore preventive
22	Shpresa Siqeca, Shtëpia e Shuaip Spahiut, Prizren
23	Shpresa Siqeca, Festimi i Shëngjergjit në Prizren /Dita e Karabash Babës/
24	Antigona Shestan & Resmija Rahmani, Java e Distrofisë Muskulare në Prizren
25	Mybexhel Zhuri, Asambleja e fëmijëve të komunës së Prizrenit
26-27	Shpresa Uka, Radio emisioni kushtuar themelimit të Asamblesë së fëmijëve në komunën e Prizrenit
28	Ciceroni kulturor
29	Faqja kulturore
30	Model i endur në vek

**Botimi i Gazetës
u mundësua nga
Zyra Për Barazi Gjimore
pranë Kuvendit Komunal
Prizren**

GRUAJA NË FOKUS

*Gazetë e ilustruar
Nr. 5, Prizren, 2014*

EDITORIAL

Numri 5 i Gazetës “Gruaja në Fokus” ofron informacione për Planin e Veprimit të Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut në Prizren për periudhën janar-qershor 2014. Gjithashtu prezantohet Raporti i Këshillit të Monitorimit mbi realizimin e Projekteve shëndetësore gjatë vitit 2013.

Vazhdojnë rubrikat: Editorial, Intervista e Gazetës, Aktivitetet e disa OJQ-ve të Prizrenit, Ilustrime dhe Radio emisionet.

“Gruaja në Fokus” vazhdon të fokusohet në aktivitetet e OJQ-ve të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe të Grupit Joformal të Grave të Prizrenit. Disa artikuj i dedikohen mbledhjeve të Zyres për Barazi Gjimore me OJQ-të e qytetit dhe aktiviteteve të atyre OJQ-ve të cilat kanë përfituar projekte nga kjo Zyre apo donatorë të tjerë. Artikujt të tjerë i dedikohen 1 Qershorit-Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve dhe aktiviteteve të tjera.

Vazhdojnë rubrikat për arkitekturën tradicionale të qytetit, trashëgiminë shpirtërore dhe modelet të endura në vek. Manifestimet, Pyetësori i Gazetës, Kuriozitetet, Ciceroni Kulturor dhe Faqja e Kulturës janë rubrika të reja që i shtohen Gazetës, me qëllim të pasurimit të mëtejshëm të saj.

Implementues i Projektit: OJQ “Shtjefën Gjeçovi” - Prizren; **Kryeredaktor:** Shpresa Siqeca; **Bashkëpunuan:** OJQ “Gruaja bashkëkohore”, Grupi Joformal i Grave të Prizrenit, Këshilli i Monitorimit mbi realizimin e projekteve shëndetësore gjatë vitit 2013; **Autorët e shkrimeve:** Mybexhel Zhuri, Drita Vukshinaj, Shpresa Siqeca, Antigona Shestan & Resmija Rahmani, Shpresa Uka; **Shtypi:** “BAF 1”-Prizren

**PLANI I VEPRIMIT I NJËSISË KOMUNALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË
PRIZREN PËR PERIU DHËN JANAR-QERSHOR 2014**

Mybexhel Zhuri, *Koordinator e Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut*

Objektiva 1

Zbatimi dhe monitorimi i rregulltë i legjislacionit mbi të Drejtat e njeriut;

Aktivitetet:

Plotësimi i pyetsorëve për zbatimin e Legjislacionit në fusha të ndryshme;

Përgjegjësitë dhe përkrahësit:

NJNJDNJ, Drejtoritë komunale, Kuvendi Komunal;

Afatet:

Janar-Dhjetor;

Rezultate:

Ritja e pjesëmarrjes aktive në hartimin e rregulloreve, në Panele intervistuese, komisione të ndryshme komunale;

Objektiva 2

Përcjellja e trendit të punësimit, në veçanti të femrave;

Aktivitetet:

Mbledhja e statistikave relevante;

Përgjegjësitë dhe përkrahësit: NJNJDNJ, Kuvendi Komunal;

Afatet:

Janar-Shkurt;

Rezultate: Ekzistimi i Statistikës relevante për gjendjen e të punësuarve dhe të papunëve në komunë;

Objektiva 3

Bashkëpunim i ndërsjellë dhe përkrahja e projekteve të OJQ-ve;

Aktivitetet: Mbledhje të rregullta mujore me OJQ-të; Mbështetja e projekteve të OJQ-ve; Promovimi i aktiviteteve përmes mediave;

Përgjegjësitë dhe përkrahësit:

NJDNJ, OJQ-të, Kuvendi Komunal;

Afatet dhe Buxheti:

Janar Dhjetor, Kuvendi Komunal;

Rezultate:

Ritja e bashkëpunimit dhe transparencës në mes të Kuvendin Komunal dhe të OJQ-ve;

Objektiva 4

Senzibilizimi i opinionit të gjerë për çështjet e grave dhe rolin e tyre në shoqërinë tonë;

Aktivitetet:

Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Grave; Aktivitete që dalin nga Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore;

Përgjegjësitë dhe përkrahësit:

NJDNJ, Kuvendi Komunal;

Afatet:

Mars;

Rezultate:

Realizimi i objektivave nga Plani i Veprimit; Përmirësimi i gjendjes së grave në komunë;

Objektiva 5

Ngritja e çështjeve gjinore, mundësive të barabarta dhe të drejtave të komuniteteve;

Aktivitetet: Përkrahja e projekteve konkrete të OJQ-ve;

Përgjegjësitë dhe përkrahësit:

NJDNJ, OJQ-të, Kuvendi Komunal;

Afatet:

Janar-Dhjetor;

Rezultate: Promovime, numri i projekteve të realizuara;

Objektiva 6

Promovimi i aktiviteteve të NJDNJ dhe OJQ-ve;

Aktivitetet:

Radio emisione, vazhdimi i botimit të gazetës “Gruaja në fokus”, TV emisione;

Përgjegjësitë dhe përkrahësit:

NJDNJ, OJQ-të, Kuvendi Komunal;

Afatet dhe Buxheti:

Janar-dhjetor, Kuvendi Komunal, Donatorë;

Rezultate:

Rritja e dëgjueshmëris së radios dhe botimi i gazetës çdo 3 muaj;

**PLANI I VEPRIMIT I NJËSISË KOMUNALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË
PRIZREN PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2014**

Objektiva 7

Vetëdijësimi i rinisë për parandalimin e dukurive negative (trafikimi me qenie njerëzore, dhuna, punët e rënda, alkooli, droga e tj.);

Aktivitetet:

Organizimi i Debateve me të rinjtë për vlerësimin e gjendjes aktuale dhe aktivitetet për parandalim e dukurive negative;

Përgjegjësitë dhe përkrahësit:

ZÇGJ, institucionet në nivel lokal, OJQ-të, Institucionet e ndryshme të qeverisë (Drejtoria e Arsimit, Qendra për Punë Sociale, Policia), Shoqëria civile, nxënësit;

Afatet:

Prill 2014;

Rezultatet:

Zhvillimi i qëndrimeve parandaluese ndaj dukurive negative si dhe angazhimi për luftimin e tyre;

Objektiva 8

Ngritja e nivelit të sigurisë ambientale dhe zhvillimore;

Aktivitetet:

Organizimi i fushatave vetëdijësuese; Materiale senzibilizuese;

Përgjegjësitë dhe përkrahësit:


Njësia për të Drejtat e Njeriut, OJQ-të, Kuvendi Komunal, Drejtoritë e Arsimit, Shëndetësisë dhe të Inspektoratit;

Afatet:

Prill-Maj 2014;

Rezultatet:

Krijimi i ambienteve më të sigurta për zhvillimin e të rinjve;



Objektiva 9

Promovimi i të drejtave të minoriteteve;

Aktivitetet:

Aktivitete të ndryshme të OJQ-ve përkatëse;

Përgjegjësitë dhe përkrahësit:

NJDNJ, OJQ-të lokale, Kuvendi Komunal;

Afatet:

Janar-Dhjetor 2014;

Rezultatet:

Krijimi i kushteve të volitshme për integrim;

Objektiva 10

Promovimi i mundësive të barabarta të PAK;

Aktivitetet:

Aktivitete të inicuar nga Komuna dhe OJQ-të përkatëse;

Përgjegjësitë dhe përkrahësit:

NJDNJ, Kuvendi Komunal, Shoqëria civile;

Afatet dhe Buxheti:

Janar-Dhjetor; Kuvendi Komunal;

Rezultatet:

Përmirësimi i cilësisë së jetës së PAK;

Objektiva 11:

Respektimi i të drejtave të fëmijëve dhe kujdesi i shtuar për zhvillimin e tyre;

Aktivitetet:

Aktivitete të ndryshme për shënimin e Ditës ndërkombëtare të fëmijëve;

Përgjegjësitë dhe përkrahësit:

Kryetari i Komunës, NJDNJ, Drejtoria e Arsimit, Kuvendi Komunal;

Afati: 1 Qershor;

Rezultatet:

Përmirësimi i kushteve shkollore dhe jetësore për fëmijët;



AKTIVITETET E ZYRES SË NJDNJ-SË DHE TË BARAZISË GJINORE TË KUVENDIT KOMUNAL TË PRIZRENIT ME OJQ-TË E QYTETIT

MBLEDHJET E ZYRES SË NJDNJ-SË DHE TË BARAZISË GJINORE ME OJQ-TË E QYTETIT

Bashkëpunimi i Zyres së Njesisë për të Drejtat e Njeriut dhe të Barazisë Gjinore me OJQ-të që veprojnë në komunën e Prizrenit dhe mirren me çështje gjinore realizohet me anë të mbledhjeve të rregullta. Këto mbledhje mbahen në sallën e Bordit të Kuvendit Komunal, Prizren.

Në mbledhjen e cila u mbajtë me datën 31.01.2014, Mybexhel Zhuri, koordinatorë e Njesisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazisë Gjinore shpalosi Planin e Veprimit të Njesisë për të Drejtat e Njeriut për vitin 2014.. Shpresa Uka, anëtare e OJQ-së “Teuta” shpalosi Raportin e Këshillit të Monitorimit mbi realizimin e Projekteve gjatë vitit 2013.

Në mbledhjen e cila u mbajtë me datën 31.03.2014 u diskutuan Projekt propozimet e OJQ-ve për vitin 2014 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë nacionale për Persona me Aftësi të Kufizuara.

Në mbledhjen e cila u mbajtë me datën 21.05.2014, u diskutua pozita e femrës dhe ngritja e nivelit të bashkëpunimit me OJQ-të në drejtim të angazhimit më të madh të femrës në vendimmarrje. Gjithashtu u diskutua rrjedha e realizimit të Projekteve të mbështetura nga Zyra e Njesisë për të Drejtat e Njeriut dhe të Barazisë Gjinore pranë Kuvendit Komunal, Prizren.

Në mbledhjen e cila u mbajtë me datën 27.06.2014, u diskutua buxhetimi me pjesëmarrje të ndjeshme gjinore dhe Projektet për të drejtat e fëmijëve.



*Erblina Kallabaku, Shoqata
e Zejtareve dhe e Afaristëve*



*Shemsije Hoxha,
OJQ “Sara”, Prizren*



*Nga e majta në të djathtë:
Malbora Krajku dhe Blerina Bytyqi*



PROJEKTET E FINANCUARA NGA ZYRA E NJDNJ-SË DHE E BARAZISË GJINORE PËR VITIN 2014

1. Ekspozita e punimeve të dorës të grave të rajonit të Zhupës, OJQ “Ključ”. Ekspozita u hap në Reçan.”;
2. Projekti “Edhe ne jemi të barabarta” /Zhvillimi i aktiviteteve të aftësisë profesionale për punime të dorës, material për punë dhe ekspozita e punimeve të grave/, OJQ “Femra për Femrat me Aftësi të Kufizuara”, Prizren;
3. Projekti për kujdesin shëndetësor të grave-ushtrime rehabilituese, OJQ “Gruaja Bashkëkohore”, Prizren;
4. Promovime mediale: Radio emisione promovuese për punën dhe aktivitetet e NJDNJ-së dhe të OJQ-ve /në Radio “Helix” dhe Radio “Prizreni”/;
5. Botimi i 2 numrave të Gazetës “Gruaja në Fokus”/Nr. 5 dhe 6/, OJQ “Shtjefën Gjeçovi”, Prizren;
5. Pagesa për interpretuesen për gjuhën e shenjave për interpretime në Kuvendin Komunal për komunitetin e shurdhër;
6. Është nënshkruar marrëveshja për bashkëpunim në mes të Kuvendit Komunal dhe OJQ-së “Iniciativa 6” për themelimin e Asamblesë së fëmijëve, për pjesëmarrje në proceset e vendimmarrjes. Asambleja u themelua më 19.06.2014.
7. Organizata e personave me Distrofi Muskulare e Kosovës-dega në Prizren /OPDMK/ dhe OJQ “Gruaja Bashkëkohore” janë mbështetur me transport për realizimin e projekteve të tyre.

MANIFESTIME

8 MARS, DITA NDËRKOMBËTARE E GRUAS

Për nder të 8 marsit, Ditës ndërkombëtare të gruas, Qendra Rajonale e OSBE-së në Prizren organizoi një aktivitet i cili u mbajtë në sallën e Bordit të Kuvendit Komunal, Prizren. Morën pjesë përfaqësueset e OJQ-ve të qytetit, Asambleistet e Kuvendit Komunal, Prizren, vajzat nga Këshilli i Veprimit Rinor Lokal dhe gjimnazi “Gjon Buzuku”.

Aktivitetet në fushën e barazisë gjinore i prezantuan: Mybexhel Zhuri, koordinatorë e NJDNJ-së dhe barazisë gjinore, Šehida Miftari, zyrtare e Qendrës Rajonale të OSBE-së në Prizren, Arjeta Nezaj, kryetare e grupit joformal të grave të Prizrenit në vitin 2013, Fjolla Gashi, OJQ “Ec ma ndryshe” dhe Shpresa Siqeca, kryeredaktore e gazetës “Gruja në Fokus”. Diskutuan: Mybexhel Zhuri, Šehida Miftari, Drita Mullaku, Asambleiste e Kuvendit Komunal etj.



*Arjeta Nezaj,
“Glorious”, Prizren*

1 QERSHORI, DITA NDËRKOMBËTARE E FËMIJËVE

Me 30.V.2014, në Sheshin “Shadërvan” dhe Qendrën për Kulturë dhe Zhvillim “Europa”, Prizren, u mbajtë manifestimi për nder të 1 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve.

Në manifestim morën pjesë fëmijët e disa qerdheve të Prizrenit, me një program të pasur kulturo-artistik /këngë, lojëra, vallëzime/.

Manifestimin e organizoi Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Zyra e Barazisë Gjinore pranë Kuvendit Komunal, Prizren.

Kuvendi Komunal çdo vjet e shënon 1 Qershorin duke u angazhuar për të drejtat e fëmijëve dhe përmirësimin e kushteve të jetës së tyre.



INTERVISTA E GAZETËS
BISEDË ME Z. LULJETA VESELAJ-GUTAJ,
PROFESORESHË NË UNIVERSITETIN PUBLIK TË PRIZRENIT

Pyetjet e parashtruara nga OJQ - të e qytetit



OJQ “SHTJEFËN GJEÇOVI”, PRIZREN

1. A mendoni se Prizreni duhet të ketë një Qendër për aktivitetet e OJQ-ve të qytetit që mirren me trashëgiminë kulturore?

Luljeta Veselaj-Gutaj: Natyrisht se po. Mendoj se duhet të ketë dyqane me gjëra tradicionale, restorane me ushqime tradicionale etj.

2. A mendoni se Prizreni duhet të themeloj Muzeun e Fëmijëve si indikator për zhvillimin e qëndrueshëm turistik të qytetit?

Luljeta Veselaj-Gutaj: Muzeu i fëmijëve është i mirëseardhur për qytetin e Prizrenit, kjo do të ndikoj në zhvillimin e kuptueshmërisë më të madhe nga ana e fëmijëve.

3. Çka duhet ndërmarrë në zhvillimin më të madh të turizmit kulturor të Prizrenit?

Luljeta Veselaj-Gutaj: Prizreni e ka traditën e vet kulturore dhe turistike, mbetet të avancohet me projekte të reja që të zhvillohet edhe më tepër turizmi këtu.

OJQ “FEMRA PË FEMRAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA”, PRIZREN

Sa do të jeni në gjendje të bëni takime me Personat me Aftësi të Kufizuara për t’iu treguar për proceset e vendimmarrjes së femrave?

Luljeta Veselaj-Gutaj: Ne jemi të gatshme për me caktue një mbledhje me Personat me Aftësi të Kufizuara, për të diskutuar rreth proceseve vendimmarrëse të femrave, sidomos të atyre me aftësi të kufizuara.

SHOQATA E GRUAS “TEUTA”, PRIZREN

A keni diskutuar për rregullimin e kanalizimit të qytetit me gypa nëntokësorë, duke marrë parasysh se kohëve të fundit Prizreni është shpallë një ndër qytetet më të bukura të botës?

Luljeta Veselaj-Gutaj: Diskutimi rreth kësaj problematike ka përfunduar. Projekti së shpejti pritet të implementohet në fshatin Vlashne ku do të grumbullohen ujërat e zeza dhe aty ku ka probleme me kanalizime do të rregullohen.

SHOQATA E FEMRAVE TË SHURDHËR, PRIZREN

A do të ketë mundësi Kuvendi Komunal të siguroj një Zyre për Shoqatën e Femrave të Shurdhër të Prizrenit?

Luljeta Veselaj-Gutaj: Mendoj se kjo pyetje duhet të adresohet Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Zyres për Barazi Gjinore pranë Kuvendit Komunal, Prizren.

PYETËSORI I GAZETËS:
ÇFARË BIBLIOTEKE TË QYTETIT DUHET TË KETË PRIZREN?

Propozimet e disa OJQ-ve të e qytetit

Për numrin 5 të Gazetes "Gruaja në Fokus" përgatitëm një pyetësor për Bibliotekën e qytetit, meqë Biblioteka e re së shpejti do të ndërtohet në Prizren. Pyetjet iu drejtuan OJQ-ve të grave të qytetit për të identifikuar nevojat për themelimin e një Biblioteke moderne si në infrastrukturë ashtu edhe në përmbajtje.

Pyetjes iu përgjigjën OJQ-të: "Femra për Femrat me Aftësi të Kufizuar", Prizren; Shoqata e Femrave të Shurdhër, Prizren;

Shoqata e gruas "Teuta", Prizren; OJQ "Shtjefën Gjeçovi", Prizren;

Propozimet do të adresohen Asamblesë Komunale të Kuvendit Komunal për të zgjeruar konceptin mbi Bibliotekën e qytetit.

**OJQ "FEMRA PËR FEMRAT ME AFTËSI
TË KUFIZUARA", PRIZREN**

1. Të ketë infrastrukturë të mirë, që të ketë qasje për Persona me Aftësi të Kufizuar;
2. Të themeloj Këndin e Fëmijëve, Këndin e të Rriturve dhe Këndin e Pleqëve, ashtu siç është Këndi amerikan;
3. Të ketë më shumë literaturë në gjuhë të huaja;
4. Të pasurohet me më shumë libra nga lëmitë e historisë, filozofisë, ekonomisë, matematikës, teknologjisë etj;
5. Të ketë hapësira të posaçme, sidomos për promovimin e librave, ashtu si në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës;
6. Të ketë libra edhe për persona të verbër të shkruar me alfabetin Braille;

**SHOQATA E FEMRAVE TË SHURDHËR,
PRIZREN**

1. Të organizohen kurse falas për gjuhën e shenjave, për persona të shurdhër;
2. Të organizohen kurse falas për ciceronë për persona që e njohin gjuhën e shenjave;
3. Të sigurohen sa më shumë libra të gjuhës së shenjave;
4. Të formohet Këndi i Leximores për persona të shurdhër.

**SHOQATA E GRUAS "TEUTA",
PRIZREN**

Të siguroj libra për femra, romane, libra shkencore, revista ilustrative të grave "Burda", "Gatojca", broshura për qëndisje, thurje të xhemperëve, trikove, si dhe gazeta ditore.

**OJQ "SHTJEFËN GJEÇOVI",
PRIZREN**

1. Të siguroj botime të reja me tematikë të femrës dhe çështjes gjinore si dhe libra të autoreve femra nga Kosova, Shqipëria dhe bota;
2. Të ketë një Foaje të përshtatshme për organizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore: orë letrare, mbrëmje poetike, koncert me muzikë klasike /të siguroj një piano dhe instrumente të tjera muzikore/;
3. Të organizohj trainime për gazetari, letërsi dhe bibliotekari;
4. Të formoj Këndet gjermane, franceze dhe italiane.
5. Të formoj Koleksionin /arkivin/ e trashëgimisë kulturore të qytetit /fotografi familjare, letra, dokumente, tregime narrative, inçizime radiofonike, videoinçizime, biblioteka private, libra të dhuruara etj.

RREGULLORJA E GRUPIT JOFORMAL TË GRAVE TË PRIZRENIT

GRUPI JOFORMAL I GRAVE TË PRIZRENIT

Neni I

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e funksionimit të Grupit Joformal të Grave të Prizrenit "GJGP".

Neni II

Grupi joformal i grave të Prizrenit u formua në baza vullnetare me ndihmën e Qendrës Rajonale të OSBE-së në Prizren. Grupin e formuan Asambleistet e Kuvendit Komunal të Prizrenit dhe OJQ-të e grave që mirren me çështje gjinore.

Grupi ka për qëllim fuqizimin e gruas për një mirëqenie më të mirë të saj. Grupi do të lehtësoj punën e Zyres për Barazi Gjinore rreth aktiviteteve, duke marrë parasysh numrin e madh të problemeve gjinore në Komunën e Prizrenit.

Neni III

- 1.Barazia gjinore dhe ngritja e gruas në të gjitha sferat;
- 2.Hartimi i Planit të Veprimit të grupit joformal të grave të Prizrenit;
- 3.Hartimi i Planit të bashkëpunimit të grupeve të grave të rajonit të Prizrenit për procesin e vendimmarrjes së grave;
4. Ndhmon Zyren për Barazi Gjinore për hartimin e Rregulloreve komunale, në pajtim me ligjin në fuqi për barazi gjinore;

5.Shqyrton propozimet dhe inicon planet lokale në fushën e barazisë gjinore;

6. Propozon programe dhe projekte autoriteteve lokale dhe qendrore në fushën e barazisë gjinore;

7.Mbështet festimin e festave lokale dhe ndërkombëtare;

8.Realizon programe shëndetësore, pedagogjike dhe kulturore në fushën e barazisë gjinore;

9.Përcjellë të arriturat e reja ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore dhe kryen punë të tjera sipas nevojës;

Neni IV

Grupi joformal i grave të Prizrenit nuk ka fuqi vendimmarrëse.

Për problemet e identifikuar, grupi joformal i grave të Prizrenit sjell rekomandime me arësytetime përkatëse Zyres për Barazi Gjinore.

Neni V

Votimi bëhet me koncensus të të gjitha anëtareve të "GJGP". Vendimet merren me shumicën e votave të anëtareve të pranishme në mbledhje;

Votohet "për", "kundër" dhe "apstenim" me ngritje të dorës.

Nëse numri i votave është i barabartë, kryesueja ka një votë shtesë;

RREGULLORJA E GRUPIT JOFORMAL TË GRAVE TË PRIZRENIT

Neni VI

1. Grupi joformal i grave të Prizrenit zgjedh Kryetaren dhe Nënkryetaren në formë rrotacioni në baza 6 mujore;
2. Kryetarja zgjidhet nga radhët e Asambleistëve të Kuvendit Komunal të Prizrenit, ndërsa Nënkryetarja nga radhët e OJQ-ve të grave;
3. Grupi joformal i grave të Prizrenit numëron rreth 15 anëtare të rregullta të të gjitha komuniteteve.
4. Mbledhjet e grupit joformal të grave të Prizrenit mbahen 1 herë në muaj ose 1 herë në dy muaj dhe sipas nevojës. Ato kryesohen nga Kryetarja dhe në mungesë të saj nga Nënkryetarja. Personat të cilët nuk janë anëtarë të Grupit por janë prezent në mbledhje kanë të drejtë të paraqesin qëndrimet dhe propozimet e tyre me lejen e Kryetares së "GJGP";

Neni VII

Shqyrtimi i ndonjë propozimi nga anëtarët do të bëhet në këtë formë: së pari flet Propozuesja; Zyrtarja për Barazi Gjimore ka të drejtën e fjalës pas Propozueses; Pas saj, fjalën e merr Kryetarja dhe pas saj të tjerat.

Neni VIII

Një anëtare e grupit joformal të grave të Prizrenit ka të drejtë të flasë vetëm njëherë për një pikë të rendit të ditës, një herë të diskutoj dhe të përgjigjet pyetjeve eventuale; Fjalimet në mbledhje zgjasin rreth 5 minuta;

Neni IX

Kryetarja e "GJGP" në bashkëpunim me anëtarët propozon rendin e ditës dhe kujdeset për mbajtjen e disiplinës gjatë mbledhjeve. Ajo ka të drejtë të urdhëroj largimin nga mbledhja të ndonjë pjesëmarrëseje e cila prish rendin dhe nuk i përmbahet kodit të "GJGP". Kryetarja shqyrton Rregulloren dhe propozon ndryshimin e saj me arësytetime përkatëse;

Neni X

Pjesëmarrëset në mbledhje janë të detyruara të respektojnë rregullat e punës; Rregullorja hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga grupi joformal i grave të Prizrenit.

AKTIVITETET E GRUPIT JOFORMAL TË GRAVE TË PRIZRENIT

GRUPI JOFORMAL I GRAVE TË PRIZRENIT

MBLEDHJA E I-rë E GRUPIT JOFORMAL TË GRAVE TË PRIZRENIT

Me datën 22.IV.2014, në Zyret e Qendrës Rajonale të OSBE-së në Prizren, u mbajtë mbledhja e I-rë e grupit joformal të grave të Prizrenit.

Morën pjesë: Asambleistet e reja të Kuvendit Komunal të Prizrenit, OJQ-të e qytetit dhe përfaqësuesit e Qendrës Rajonale të OSBE-së në Prizren. Mbledhjen e përshëndeti z. Ulrich Biffar, ushtrues i detyrës së Zyres Rajonale të OSBE-së.

Qendra Rajonale e OSBE-së në Prizren konfirmoi se ajo edhe këtë vit do të implementoj disa aktivitete me grupet joformale të grave të Kosovës:

Aktiviteti 1: Organizimi i mbledhjes së grupit joformal të grave të Prizrenit, me qëllim të rikonfirmimit dhe të përforcimit të këtij grupi.

Aktiviteti 2: Takimi i grupit të grave të rajonit të Prizrenit me përfaqësueset e grave të Kuvendit të Kosovës i cili do të mbahet në Prizren me datën 13.V.2014.

Aktiviteti 3: Tryeza e rumbullakët për shkëmbimin e përvojave mes përfaqësueseve të grupeve joformale të grave të Prizrenit, Dragashit, Gjakovës, Deçanit, Klinës dhe Istogut i cili do të mbahet në Prizren me datën 13.VI.2014.

Në mbledhje u dhënë propozimet për Planin e Veprimit për vitin 2014:

1. Lobimi për formimin e Qerdhes publike në qytet;
2. Vizita në Shqipëri me qëllim të hulumimit të tregut rajonal për formimin e bizneseve private /Shkodër, Krujë/;
3. Lobimi për hapjen e vendeve të reja të punës për gratë RAE dhe të komuniteteve të tjera;
4. Trainimi për shkrimin e Planit të Biznesit;
5. Hartimi i Statutit të grupit joformal të grave të Prizrenit;
6. Lobimi për rregullimin e pjerrinave për Persona me Aftësi të Kufizuara;
7. Promovime mediale në Radio “Helix” dhe Radio “Prizren”;
8. Krijimi i Rrjetit të grupeve joformale të grave të Kosovës;

Bazuar në këto propozime do të hartohet Plani i Veprimit për vitin 2014.

Me shumicë votash, Luljeta Veselaj-Gutaj u zgjodh kryetare e Grupit Joformal të Grave të Prizrenit për vitin 2014.



*Sehare Maliqi,
Asambleiste e Kuvendit Komunal, Prizren*



*Drita Krasniqi,
OJQ “Oaza”, Prizren*

AKTIVITETET E GRUPIT JOFORMAL TË GRAVE TË PRIZRENIT

TAKIMI I GRUPEVE JOFORMALE TË GRAVE TË RAJONIT TË PRIZRENIT ME PËRFAQËSUESET E GRAVE TË KUVENDIT TË KOSOVËS

Më 13.V.2014, në Ndërtesën e Kuvendit Komunal, Prizren u mbajtë takimi i grupit të grave të rajonit të Prizrenit me përfaqësueset e grave të Kuvendit të Kosovës.

Takimi kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave më të mira për mënyrat e përfshirjes së grave në vendimmarrje si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror dhe mundësitë e grave të ndikojnë në vendimmarrje.

Fjalën hyrëse e mbajtën përfaqësueset e Kuvendit të Kosovës. Në takim u diskutua mbi temat:

1. Fuqizimi i grave në zgjedhje;
2. Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje lokale;
3. Mbështetja e personave kyç në fuqizimin e grave në nivel lokal dhe qendror;

Në fund u dhënë konkluzionet dhe u arritë marrëveshja për aktivitete të mëtejshme.

Takimin e organizoi Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë /OSBE/, Misioni në Kosovë.

TRYEZË E RRUMBULLAKËT E GRUPEVE JOFORMALE TË GRAVE TË PRIZRENIT, DRAGASHIT, GJAKOVËS, DEÇANIT, KLINËS DHE ISTOGUT

Me datën 13.VI.2014 në Restaurant “Marash” në Prizren, u mbajtë Tryeza e rrumbullakët për shkëmbimin e përvojave mes përfaqësueseve të grupeve joformale të grave të Prizrenit, Dragashit, Gjakovës, Deçanit, Klinës dhe Istogut. Tryezën e organizoi Zyra Rajonale e OSBE-së në Prizren.

Në Tryezë morën pjesë përfaqësueset e Zyres Rajonale të OSBE-së në Pejë dhe Prizren dhe përfaqësueset e grupeve të grave të Prizrenit, Dragashit, Gjakovës, Deçanit, Klinës dhe Istogut.

Menagjerët e projektit nga Zyret Rajonale të OSBE-së prezantuan ecuritë dhe të arriturat e grupeve joformale të grave të gjashtë komunave.

Kryesueset e grupeve joformale të grave në bashkëpunim me Zyrtaret për Barazi Gjinore prezantuan shkurtimisht aktivitetet e deritashme të realizuara në komunat e tyre.

Pas prezantimeve u dhënë konkludimet dhe rekomandimet për aktivitete të mëtejme. U rekomanduan takimet e reja për vazhdimin e bashkëpunimit në mes të këtyre komunave.



NDIHMO SOT PËR NJË TË ARDHME MË TË MIRË TË GRAVE DHE VAJZAVE


OJQ “Gruaja bashkëkohore” është duke implementuar projektin “Ndhmo sot për një të ardhme më të mirë të grave dhe vajzave”. Projekti ka filluar në muajin dhjetor të vitit 2013 dhe ka përfunduar në muajin maj të vitit 2014.

1. TRAINIMI: LIGJI I BARAZISË GJINORE DHE TË DRAJTAT E GRAVE

Në kuadër të aktivitetit 1, me datën 8.II.2014 në zyret e OJQ-së “Gruaja bashkëkohore” u mbajtë Trainimi “Ligji i barazisë gjinore dhe të drejtat e grave”.

Në trainim morën pjesë përfaqësueset e OJQ-ve të qytetit, përfaqësueset e mediave, mësimdhënëset etj.

Trainimin me temën “Prezantimi i Ligjit për barazi gjinore” e mbajti Mybexhel Zhuri, Koordinator e NJDNJ e cila gjithashtu foli edhe për Zyrat e barazisë gjinore në Kosovë. Pas përfundimit u hap diskutimi, u parashtruan pyetjet dhe u dhënë rekomandime rreth Ligjit për barazi gjinore. Diskutuan: Nadire Thaqi, Fetije Mehmeti, Drita Vukshinaj etj.



2. LIGJERATA: SHËNDETI I GRAVE

Në kuadër të aktivitetit 2, u mbajtën 5 ligjerata nga ana e mjekëve për sëmundjet përkatëse:

1. Ligjerata për rrezikun nga kanceri i gjirit e cila u mbajtë nga Dr. Shpresa Llukaj-Goçaj;
2. Ligjerata për shëndetin e dhëmbëve;
3. Ligjerata për shëndetin e zemrës;
4. Ligjerata për shëndetin e eshtrave;
5. Ligjerata për fizioterapi;


3. KËMBIM PËRVOJASH VIZITË PUNE NË DRAGASH

Në kuadër të aktivitetit 3, 20 gra nga Prizreni e vizituan Dragashin ku u takuan me 10 gra të Dragashit dhe bashkarisht trajtuan problematikën e çështjes gjinore.

Udhëheqëse e projektit “Ndhmo sot për një të ardhme më të mirë të grave dhe vajzave” ishte Fetije Mehmeti, Drejtoreshë e OJQ-së “Gruaja bashkëkohore”.

Donator i projektit ishte Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës /RRGGK/.





*Trainimi “Ndihmo sot për një të ardhme më të mirë të grave dhe vajzave”,
organizuar nga OJQ “Gruaja bashkëkohore”, Prizren*



Ekspozita artistike e organizuar nga Ater Koro, Mars 2014, Prizren



Festimi i Shëngjergjit /Dita e Karabash Babës/, Prizren



*Panairi i artizanateve 3-5.V.2014,
OJQ "Femra për Femrat me Aftësi të Kufizuara", Prizren*



*Panairi i veshjeve kombëtare tradicionale të
trojeve shqiptare dhe artizanateve,
12-14.VI.2014, Prizren*



1 Qershori, Dita Ndërkombëtare e fëmijëve, Prizren



Model i endur në vek, Prizren



136 Vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 10.VI.2014, Prizren





*Myrvete Xhezairi /Shoqata
Ndërkomunale e të Verbërve
dhe Atyre me të Pamë të Dobësuar*



Maqinë shkrimi për të verbër me alfabetin "Braille"



*Tryeza e rrumbullakët për realizimin e politikave gjinore në Komunën e Prizrenit, 13.III.2014, Prizren
OJQ "Dora Dorës", Prizren*



OJQ "Handikos"- Qendra e Rehabilitimit e Bazuar në Bashkësi, Prizren




*Nga e majta në të djathtë: Seylan Groša dhe Şenaj Buza,
Shoqata e Biznesmenëve dhe Zejtarëve "Esnaf",
Prizren*



*Lule të punuara prej sapuni, Shoqata e
Biznesmenëve dhe Zejtarëve "Esnaf",
Prizren*



*Nga e majta në të djathtë: Myzaferre Jelliqi
dhe Shpresa Makasçiu, Shoqata e Zejtarëve
dhe e Afaristëve, Prizren*



*Fjolla Gashi,
OJQ "Ec ma ndryshe",
Prizren*



*Nadire Thaqi,
Radio "Prizreni",
Prizren*



Sibel Sumuç



Elmedina Arapi

*Ekspozita e fotografive të Sibel Sumuç dhe Elmedina Arapit
"Emri i dhunës është gruaja", 12.II.2014, Prizren*



*Myqerem Karaçi,
Shoqata e Femrave të
Shurdhër, Prizren*

AKTIVITETET E OJQ-së

“FEMRA PË FEMRAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA”, PRIZREN

Drita Vukshinaj

OJQ” Femra për Femrat me Aftësi të Kufizuara” /FFAK/, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 realizoi disa projekte:

I. Përfundoi projekti për kuzhinën tradicionale prizrenase dhe u shtyp publikimi: **“Erërat e gjellëve të harruara prizrenase”**. Projekti u përkrah nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij-Zyra në Prishtinë /CHWB/.

II. Edhe këtë vjet OJQ “FFAK” e vazhdoi projektin **“Ngritja e kapacitetit të Gruas në proceset e Paqe-bërjes dhe Paqe-ruajtjes”**, i cili përkrahët nga UNDP. Në kuadër të projektit u mbajtë Trainimi me Drejtorët e Drejtorive të Kuvendit Komunal të Prizrenit lidhur me buxhetimin gjinor. Ky projekt do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

III. U realizua projekti **“Iniciativa për zhvillimin dhe avancimin e femrave-Arti gjuhë e përbashkët”** i cili u përkrah nga Agjensioni për Barazi Gjinore të Kosovës. Projekti zgjati 5 muaj. Në kuadër të tij u mbajtën disa aktivitete:

1. Trainimi “Hapat e para për hapjen e një mikro-biznesi të suksesshëm” u përcjell nga 15 gra me aftësi të kufizuara. Temat e trainimit kishin të bënin me mënyrën e themelimit të një biznesi afatgjatë.

2. Trainimi dhe aftësimi profesional i 7 femrave me aftësi të kufizuara në ngjyrosje në pëlhurë. Gjatë trainimit femrat u furnizuan me materiale shpenzuese dhe përgatitën punime për me i promovue në Panairin e artizanateve;

IV. Është duke u realizuar projekti **“Zhvillimi ekonomik me artizanate të ndryshme”** i cili përkrahët nga Projekti i Këshilli European “Culture for All”.

V. Projekti **“Edhe ne jemi të barabarta”** e financuar nga Zyra për Barazi Gjinore pranë Kuvendi Komunal do të zgjasë 5 muaj. Në kuadër të tij janë paraparë disa aktivitete:

1. Punimi i artizanateve nga anëtarët e OJQ-së “FFAK”. Çdo javë ato do të punojnë punime dore dhe në fund do ti promovojnë në panairë;

2. Kursi i kuzhinës tradicionale i cili u organizua në lokalitë të OJQ-së “FFAK”. Kursi është realizuar pas iniciativës së disa femrave të cilat kanë kërkuar organizimin e tij.

3. Trainime psiko-sociale /do të mbahen tri trainime/.

Projekti do të përfundojë me një vizitë një ditore në Vermicë ku do të marrin pjesë 20 femra. Vizita do të përcillet me një drekë soleme.

VI. Më 3-5.05.2014 OJQ “FFAK”, për nder të festës popullore të Shën Gjergjit organizoi panairin, i cili u përkrah nga Struktura e Gruas Demokratike, dega në Prizren. Në panair morën pjesë shoqatat e femrave të cilat i promovuan punimet artizanale të komunës së Prizrenit.

Më 24-28.III.2014, Drita Vukshinaj, kryetare e OJQ-së “FFAK” mori pjesë në aktivitetin “Java e Gruas” e cila u organizua në Prishtinë. Ndërkaq në muajin prill mori pjesë në Trainimin dyditor “Akademia e Grave në Liderhip” i cili do të realizohet në 4 module. Të dy aktivitetet u organizuan nga Instituti Kombëtar Demokratik /NDI/.

Drita Vukshinaj, është në grupin avokues të Rrjetit të Grupit të Grave të Kosovës. Prej datës

28-30.III.2014 mori pjesë në Trainimin për avokim që u mbajtë në Durrës, bashkë me 4 gra Asambleiste të Kuvendit Komunal të Prizrenit dhe gra Asambleiste nga të gjitha qytetet e Kosovës. Trainimin e përkrahu Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës /RrGGK/, Prishtinë.

Me datën 11.IV.2014, Drita Vukshinaj organizoi në Prizren shfaqjen e filmit “Iron Jawed Angels” e cila u mundësua nga Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës /RRGGK/.



OJQ ”Femra për Femrat me Aftësi të Kufizuara”,

Rr. Z.Pajaziti p.n.

E-mail/femra-femres@hotmail.com/;

dritavukshinaj3371@hotmail.com

Mob/ 044/953-617

PËRMIRËSIMI I SHËNDETIT TË GRAVE DHE VAJZAVE DHE NGRITJA E CILËSISË SË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE PREVENTIVE

/ Raporti i Këshillit të Monitorimit mbi realizimin e projekteve shëndetësore gjatë vitit 2013/

Objektiva 1:

Ngritja e vetëdijes së grave dhe vajzave për vizita të rregullta shëndetësore preventive dhe vizita të tjera;

Aktivitetet:

Fushata senzibilizuese, trainime, fletushka, ligjerata, vizita mjekësore të rregullta;

Treguesit:

Numri i fushatave, trainimeve, vizitave dhe fletushkave të shpërndara;

Përgjegjësit:

Drejtorja Komunale e Shëndetësisë (DKSH);
Kuvendi Komunal, Prizren;
OJQ-të,
Mediat;
Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Zyra e Barazisë Gjinore pranë Kuvendit Komunal, Prizren;

Informacione që duhet mbledhur:

Sa aktivitete janë mbajtur?
Sa gra në total kanë përfituar?
Sa herë në vjet mund të lejohen aktivitete të tilla?

Burimi i informacionit:

Drejtorja Komunale e Shëndetësisë /DKSH/;
Kuvendi Komunal;
OJQ-të “Foleja” dhe OJQ “Iniciativa 6” dhe Grupi i Grave “Oaza”, Prizren;

.Veprimet dhe rezultatet e arritura:

Projekti ngërthen në vete ekzaminimin e 10 grave të komunitetit Rom Ashkali Egjiptian në Komunën e Prizrenit.

Është bërë ekzaminimi i papa testit, mamografisë, ultrasonografisë për gra dhe ka përfunduar me një rezultat të kënaqshëm sepse nuk është hasë në sëmundje patologjike, pos në disa raste ku mjeku ka rekomanduar terapi me barna.

Në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Prizren janë kryer 650 ekzaminime (falas) të ultrazërit dhe mamografisë së grave të komunës së Prizrenit me rrethin dhe të komunave Rahovec, Dragash, Suharekë dhe Malishevë.

Vlerësimi dhe analiza:

Pjesëmarrja e grave të përfshira në projekt në ekzaminimin e papa testit tregon vetëdijësimin e grave të këtij komuniteti për kujdesin primar të shëndetit të tyre me ineresim të shtuar për ekzaminime të tjera që i përkasin shëndetit të gruas.

Preferohet që projekti të përmbaj edhe ligjërata për shëndetin e gruas me qëllim të ngritjes së vetëdijësimit të mëtijmë të grave të këtij komuniteti.



Shpresa Uka, OJQ “Teuta”, Prizren

PËRMIRËSIMI I SHËNDETIT TË GRAVE DHE VAJZAVE DHE NGRITJA E CILËSISË SË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE PREVENTIVE

Objektiva 2:

Ngritja e vetëdijës së grave dhe vajzave për rrezikun e kancerit të gjirit dhe mitrës;

Aktivitetet:

Fushata senzibilizuese, trajnime për vetëekzaminim, vizita të rregullta gjinekologjike, mamografi;

Treguesit:

Numri i fushatave, trajnimeve, vizitave, i pjesëmarrëseve;

Përgjegjësitë:

Drejtoria Komunale e Shëndetësisë; Qendra Komunale e Mjekësisë Familjare;
Njësia për të Drejtat e Njeriut,
OJQ-të dhe mediat;

Informacioni që duhet mbledhur:

Në cilat fshatra janë mbajtur fushatat?
Çfarë lloje të aktiviteteve janë mbajtur?
Sa ka qenë numri i pjesëmarrësve?
Sa fushata/trajnime/ janë mbajtur?
Sa është numri i vizitave?

Burimi i informacionit:

Dr. Shpresa Llukaj Goçaj,
Mybexhele Zhuri,
Qendra Rajonale e OSBE-së në Prizren;

Faza e zbatimit:

Faza e zbatimit të dy objektivave ka përfunduar;

Veprimet dhe rezultatet e arritura

Rezultatet që janë evidentuar janë se nga ekzaminimi janë zbuluar pesë raste të kancerit të gjirit, raste të konfirmuara me histopatologji (3 gra nga qyteti dhe 2 nga fshatrat) që më pas nga mjekja specialiste janë referuar tek kirurgu torakal.

Projekti në fjalë ngërthen në vete edhe ligjërata vetëdijësuese për kancerin e gjirit të cilat janë mbajtur në fshatrat Romajë ku kanë marrë pjesë 50 gra, Reqan-40 gra, Lubinje e Ulët-40gra, Gjonaj-120 gra dhe Skorobisht-20 gra. Gjatë aktiviteteve janë shpërndarë edhe materiale senzibilizuese dhe fjonga roze të cilët simbolizojnë solidaritetin gjatë 16 ditëve të aktiviteteve.

Shumë promovime janë bërë përmes radio emisioneve të organizuara nga Kuvendi Komunal dhe Qendra Rajonale e OSBE-së në Prizren..

Vlerësimi dhe analiza

Vet pjesëmarrja e numrit të madh të grave në ligjërata vetëdijësuese është indikator i rëndësishëm së projektit. Shumica e grave për herë të parë kanë dëgjuar për ekzistimin e pajisjeve për ekzaminimin e gjirit në Qendrën Komunale të Mjekësisë Familjare në Prizren. Për përfshirjen e sa më shumë fshatrave të Prizrenit për vetëdijësim nga rreziku i kancerit të gjirit nevojitet vazhdimësia e ligjëratave gjatë tërë vitit.

Periudha e monitorimit:

Projekti është implementuar gjatë muajve korrik-dhjetor 2013 dhe prej datës 01.X-31.XI.2013 (përfshirë edhe vikendet).

SHTËPIA E SHUAIP SPAHIUT, PRIZREN

Shpresa Siqeca

Konaku i Shuaip Spahiut ishte njëri prej konaqeve më impresive të arkitekturës folklorike të pjesës rrafshinore të qytetit. Shuaip Spahiu ishte nënkryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e më vonë Ministër i Financave të Lidhjes.

Konaku ndodhej në qendrën urbane të qytetit, në Zonë Historike të tij. Ndodhej në afërsi të lagjes së Shadërvanit, në bregun e majtë të lumit, pranë urës së Naletit, shtëpisë së Veli Bratkes dhe një mulliri të vjetër.

Konaku ishte ndërtuar në shekullin XIX. Ishte i kthyer kah rruga dhe ndodhej në kënd. Konaku kishte formë simetrike. Themelet dhe kati përdhes kanë qenë të ndërtuar prej gurësh të lidhur me llaç. Kati i sipërm ka qenë i ndërtuar prej qerpiçeve. Gjatë muratimit janë përdorur hatulla druri. Konaku kishte katin përdhes, mezokatin dhe katin e dytë.

Kati i sipërm dilte nga volumi i katit përdhes dhe mezokatit në formë të konsolit dhe përfundonte me një tra të veshur me një dërrasë me skaje të dhëmbëzuara. Shquhej qoshku i mbyllur “divanhane” i cili dilte me një pjesë të tij jashtë volumit të katit përdhes dhe rrinte pezull mbi rrugë. Kishte formën e pesëkëndëshit, me dritare në të gjitha faqet. Në katin e sipërm ndodheshin çardaku, katër dhoma, kafe oxhaku, ku zienin kafe dhe çaj për miq, si dhe banja me abdeshtan.

Dhomat ishin të vendosura në katër kënde të katit. Ato ishin të mëdha dhe komode. Dyshemetë e dhomave ishin të shtruara me dërrasa, mbi të cilat ishin të shtruara qilima të endur prej leshi.

Elementet e enterierit të dhomave të punuara prej druri me teknikën e drugdhendjes ishin të një niveli të lartë artistik. Ato i kishin punuar mjeshtrit dibranë duke aplikuar motivet e lashta të karakterit floral, gjeometrik, zoomorf, kozmik etj. Shquheshin elementet e enterierit të dhomës së miqve. Dera ishte e mbaruar prej druri. Pjesa e poshtme e sfondit ishte e veshur me dërrasa të vendosura horizontalisht dhe vertikalisht, të cilat formonin fusha në trajtë katërkëndëshi e katrori me madhësi të ndryshme. Pjesa e epërme ishte

e veshur me dërrasa të vendosura në trajtë rombi. Dera përforcohej me tri rende gozhda hekuri me koka të vogla. Pjesa e epërme kishte një shtesë prej druri, e cila ishte pak e dekoruar në skaje. Tavani ishte i shtruar me dërrasa dhe rrethohej me kornizë druri. Sfondi i qendrës ishte i veshur me listela paralele. Ai kishte rozetën në formë të tetëkëndëshit dhe katër cepa në formë të trekëndëshit, të gdhendura në relief. Në një kënd të dhomës ndodhej dollapi i madh dykrihësh “jyklyk-u” i cili shërbente për vendosjen e shtrëjeve të gjumit. Përfundi dollapit ndodhej një dollap shumë i vogël dykrihësh i cili shërbente për vendosjen e enëve.

Në të dy anët e jyklyk-ut ndodheshin dy dollapë të vegjël të cilët shërbenin për vendosjen e rrobave. Këta dollapë kishin nga një kamare në pjesën e poshtme. Në pjesën e epërme, ato ishin të zbukuruar me një rrjetë druri në formë të rombit.

Në ballin e dhomës ndodhej oxhaku i dekoruar në relief me motive florale, motivin e diellit dhe motive të tjera.

Konaku i Shuaip Spahiut është djegur në vitin 1999. Deri vonë, nga rrënojat që kishin mbetur, mund të vërehej një oxhak i katit, i cili ishte i zbukuruar me motivin e diellit në formë të lules gjashtëfletëshe.

Transformimet në shtëpi janë bërë në vitet e 60-ta, me ndarjen e shtëpisë në dy pjesë, për dy familje. Në katin përdhes u hapë shitorja, ndërkaq në oborr u ndërtua shtëpia për banim. Në fund të vitit 2010 Konaku filloi me u rindërtue sipas pamjes së vjetër. Punimet rreth rindërtimit janë kryer më 2011.

Konaku ka rëndësi arkitektonikë, historike dhe artistike, sepse i takon njërit prej personaliteteve më të shquara të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Konaku i Shuaip Spahiut është vënë në mbrojtjen e ligjit nga ana e Entit për Mbrojtjen e Përmendoreve të Kulturës së Kosovës, me aktvendimin nr. 957/64.

Shpresa Siqeca

Më 5 maj, në varrezat e vjetra myslimane të qytetit, edhe sot e kësaj dite mbahet një manifestim ku mblidhet turmë e madhe e banorëve prizrenas dhe e fshatrave, që i takojnë komunës dhe rajonit të tij.

Ky është vendpikniku tradicional prizrenas, ku kremtohet festa e shëngjergjit dhe njëkohësisht vendkulti mysliman, sepse në varreza ndodhen tri tyrbe, në të cilat kryhen veprime-rituale e ceremoni fetare. Këto janë: tyrbja e Vajzës, tyrbja e shejh Hyseinit dhe tyrbja e Karabash Babës.

Kjo ditë nga qytetarët njihet si dita e Karabash Babës.

Në këtë vend, bëhet një lloj panaxhyri. Vorbëtarët vendës i rendisin në tokë dhe i shesin vegshat, vorbat e shtambat të cilat i kanë punuar me dorë dhe me vegla gjysmë të mekanizuara.

Përveç këtyre shiten prodhime prej plastike, kryesisht lodra fëmijësh dhe mjete për zbukurimin e tyre /krehra e pasqyra/. Këto prodhime më së shumti i blejnë fëmijët. Shiten edhe stoli prej bizhuterie nga metali i derdhur i mjeshtërve vendës dhe janjevas. Këto janë kryesisht stoli për fëmijë dhe vajza të reja /unaza, orë, vathë e hallka/. Këtu shiten edhe prodhime prej druri, si djepe të vogla të ngjyrosura.

Fëmijët argëtohen duke shëtitur, lozur, ngrënë si dhe me luhatësit shetitës. Kudo jehon kënga e gëzueshme dhe vallet të përcjella me lodra, gërmetë e def.

Me të dalë nga varrezat ndodhen vreshtat, në të cilat çdo pjesëmarrës, e veçanërisht të rinjtë shkojnë dhe mbledhin lule, hithra, gjethe e fletë të njoma të arrave. Me këto bëjnë kurora dhe i stolisin dyert e dritaret e shtëpive dhe të dyqaneve, arkat e nuseve si dhe ua vënë

bagëtisë në kokë. Poashtu, lulet dhe gjelbërimet i vënë në kokë të fëmijëve, duke besuar se në këtë mënyrë do të largohen të ligat. Pastaj, këto gjelbërime i hedhin në ujë.

Në ditën e shëngjergjit /6 maj/, heret në mëngjes, nënat i lajnë fëmijët me ujin, në të cilin kanë qëndruar gjethet, fletët e arrave si dhe lëvozhga vezësh të ngjyrosura, që i kanë ruajtur prej festës së pashkëve.

Larja e fëmijëve besohet se siguron shëndet gjatë tërë vitit dhe i bën faqet e tyre të njoma, të lëmueshme e të bardhë si veja.

Në vreshta dhe në varreza afër tyrbeve, njerëzit mbledhin fole thneglash, të cilat i vendosin në magje të bukës, për t'u shtuar begatia gjatë vitit. Pasi të kthehen nga vreshtat, njerëzit bestytë u afrohen të tria tyrbeve dhe kryejnë disa ceremoni rreth tyre. Sipas gojëdhënave, në Tyrben e Vajzës është e varrosur e bija e një pasaniku, e cila ka vdekur e re.

Tyrbja e shejh Hyseinit është ndërtuar në vitin 1926. Shejh Hyseini ka qenë pjesëtar i rendit të dervishëve Halveti. Edhe kjo tyrbe ka vizitorë të shumtë, të cilët vijnë të bëjnë zotimin për shëndet dhe plotësimin e dëshirave të ndryshme.

Tyrbja e Karabash Babës është në formë gjashtëkëndëshe, me pullaz konik. Ekzistojnë mjaft legjenda që flasin për shembëlltyrën mistike të Karabash Babës dhe aftësitë e mbinatyrshme për të bërë çudi, të cilat i kanë nxitur vazhdimisht njerëzit të tubohen dhe t'i besojnë forcës mjekuese të tij.

Në shumë shtëpi prizrenase përgatitet ëmbëlsira prej gruri "ashure". Gruri shtypet në havan dhe pastaj zihet me ujë disa orë me nxehtësi të ngadalshme. Sipas mundësisë, ëmbëlsirës i shtohen arrat dhe rrushi i thatë. Kjo ëmbëlsirë përgatitet në shenjë gëzimi, që e përjetuan ardhjen e këtij shëngjergji. Me këtë rast anëtarët e familjes i urojnë njëri-tjetrit që të përjetojnë edhe shumë shëngjergje të tjera.

JAVA E DISTROFISË MUSKULARE NË PRIZREN

Antigona Shestan & Resmija Rahmani

Me rastin e shënimit tradicional të manifestimit “Java e Distrofisë Muskulare”, Organizata e Personave me Distrofi Muskulare e Kosovës-dega në Prizren /OPDMK/, nga data 27.05.2014-01.06.2014 organizoi aktivitete të cilët zgjatën gjashtë ditë. Ato u organizuan në Kështjellën e qytetit, Lagjen “Shadërvan”, Qendrën Kulturore “Yunus Emre”, Kompleksin për Zhvillim dhe Kulturë “Europa”, Parkun e Qytetit “ZONA”, si dhe në Vërmicë dhe Durrës.

Dita e I-rë (27.05.2014)

1. Lëshimi e tullumbaceve nga Kështjella e qytetit dhe sheshi “Shadërvan”;
2. Ekspozimi i një lisi të punuar artistikisht, me mesazhe të vendosura në të, të hartuara nga personat me aftësi të kufizuara. Në ta, ata tregojnë sfidat që kanë në jetë dhe nevojat e tyre;
3. Ekspozimi në tendë dhe shprëndarja e Fletëpalosjeve me kërkesa për personat me distrofi muskulore. Fletëpalosjet i shprëndanë personat me nevoja të veçanta në baza vullnetare;
4. Skeqe-Performanca ku performuan anëtarët e OPDMK-së me qëllim të paraqitjes së barrierave me të cilat ballafaqohen gjatë qasjes në institucionet publike, qasjes së vështirësuar në shërbimet institucionale, përfshirë të verbrit dhe të shurdhërit;
5. Vendosja e këndit informativ për media, ku OPDMK prezanton aktivitetet dhe porositë përfaqësuesve të mediave lokale;
6. Dorëzimi i rekomandimeve për Drejtoritë përgjegjëse pranë Kuvendit Komunal të Prizrenit lidhur me qasjen e personave me aftësi të kufizuara në shërbimet që përmirësojnë jetën e tyre.

Dita e II-të (28.05.2014)

1. Vizitë pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës /FSK/ në Istog dhe dorëzimi i mirënjohjes për përkrahjen e vazhdueshme të tyre. Gjatë vizitës personat me nevoja të veçanta u njoftuan me angazhimet e pjesëtarëve të FSK-së.

Dita e III-të (29.05.2014)

1. Ligjerata nga mjeku neurolog Medi Shehu rreth simptomave dhe ballafaqimeve me distrofi muskulore si dhe debati rreth sëmundjes-me synim që qytetarët të informohen rreth saj;
2. Programi kulturo-artistik i Ansambleve Folklorike “Agimi”, “Dogri-Yol” dhe “Šarski

Behar”; Personat me aftësi të kufizuara u shoqëruan me anëtarët e rinj të Ansambleve dhe biseduan për organizimin e përbashkët të ngjarjeve kulturore, si kontribut në sferën e kulturës.

Dita e IV-të (30.05.2014)

Dita artistike për fëmijët me nevoja të veçanta:

1. Punëtori (vizatim, ngjyrosje, lojë, shoqërim, argëtim);
2. Shikimi i Filmit vizatimor për fëmijët në kinemanë “Dokukino”. Fëmijët do t’i shoqërojnë vëllezërit dhe motrat, të cilët kujdesen çdo ditë për ta.

Dita e V-të (31.05.2014)

1. Aktivitete sportive me persona me nevoja të veçanta nga 10 komuna të Republikës së Kosovës: shah, rrëzimi i duarve, pikado, mini-turne tenisi, ping-pong, gara në pistën e thjeshtë të vrapimit në 100 metra dhe zig -zag, basket në karroca, gara me karroca të thjeshta dhe karroca elektro-motorike. Pasi që deri më tani distrofistët kanë qenë vetëm vëzhgues të sporteve dhe të diskriminuar në këtë drejtim, me këto gara u mundësohet të përfshihen në aktivitetet sportive dhe të tregojnë se në disa sporte mund të jenë të barabartë me të tjerët.
2. Ndarja e medaleve për 3 vendet e para;

Dita e VI-të (01.06.2014)

1. Vizitë e OPDMK-së në Vërmicë me qëllim të pastrimit të mjedisit, relaksimit dhe argëtimit;
2. Gara në peshkim në mes të peshkatarëve profesionalë dhe personave me nevoja të veçanta;
3. Ndarja e Medaleve dhe mirënjohjeve për 3 vendet e para në gara në peshkim;

Dita e VII-të (25.06.2014)

Vizitë njëditore në Durrës për 20 anëtarë të OPDMK-së, me qëllim të rehabilitimit dhe rekreacionit.

ASAMBLEJA E FËMIJËVE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT

Mybexhel Zhuri, *Koordinator e Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut*

Asambleja e fëmijëve (Konventë e miratuar nga Asambleja e përgjithshme me Rezolutën e saj nr. 44/25 të datës 20.11/1989 ndërsa ka hy në fuqi më 2.09.1990

Me Planin Nacional të Veprimit për të Drejtat e fëmijëve në Republikën e Kosovës i cili synon t'i arrijë standardet ndërkombëtarë të të drejtave të fëmijëve të përcaktuara me Konventën për të drejtat e fëmijëve, është përcaktuar Vizioni, sipas të cilit Kosova do të jetë një nga vendet më të mira për fëmijët për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë.

Prandaj Qeveria e Kosovës punon në drejtim të mundësimit të përmbushjes dhe implementimit të plotë të standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Këto e realizon duke krijuar dhe fuqizuar mekanizma që do të sigurojnë zbatimin e normave ndërkombëtare duke marrë parasysh edhe zërin e fëmijëve. Kjo gjithashtu nënkupton edhe angazhimin e Qeverisë lokale për krijimin dhe zhvillimin e kushteve sa më të përshtatshme për zhvillim dhe jetën me dinjitet të fëmijëve.

Njësia për të Drejtat e Njeriut mbështet krijimin e mekanizmave dhe strukturave përfaqësuese të zërit të fëmijëve për të formuar një sistem të komunikimit të drejtpërdrejtë dhe krijimin e lidhjeve më të forta ndërmjet fëmijëve dhe Institucioneve të Qeverisë.

Prandaj Njësia për të Drejtat e Njeriut ka mbështetur projektin e OJQ-së “Iniciativa 6” për themelimin e Asamblesë së fëmijëve të Komunës së Prizrenit dhe do të angazhohet që ai të zbatohet në mënyrë të duhur.

Asambleja e fëmijëve të Komunës së Prizrenit u inicua në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të fëmijëve, 1 Qershori. Ajo u inaugurua solëmnisht më 19. 06. 2014, në mbështetje të Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit Komunal.

19. 06. 2014 do të jetë datë e rëndësishme për të gjithë, e në veçanti për fëmijët e Komunës së Prizrenit.

Qëllimi kryesor i themelimit të Asamblesë së fëmijëve të komunës së Prizrenit është pjesëmarrja e fëmijëve në procesin e vendimmarrjes dhe të vetëdijësisimit të shoqërisë sonë për të drejtat e fëmijëve.
Rreth themelimit të Asamblesë, Njësia për të Drejtat e Njeriut organizoi një radio emision në Radio “Helix”.



RADIO EMISIONI KUSHTUAR THEMELIT TË ASAMBLESË SË FËMIJËVE NË KOMUNËN E PRIZRENIT

Shpresa Uka

Radio emisioni kushtuar themelimit të Asamblesë së fëmijëve në komunën e Prizrenit u emitua në Radio Helix me datën 24. 06. 2014, ora 14.00-15.00

Kush e implementon Projektin për të drejtat e fëmijëve pakicë në Komunën e Prizrenit ?

Ibrahim Krusha: Projektin për të drejtat e fëmijëve pakicë në Komunën e Prizrenit në partneritet me Save the Children realizohet në 7 komuna: Prizren, Gjakovë, Pejë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë dhe Prishtinë.

Qëllimi i Projektit është themelimi i Asambleve të fëmijëve në disa komuna, ndërsa faza e dytë është fuqizimi i Asambleve dhe ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të tyre.

Asambleja e fëmijëve në Prizren ka të bëjë me mbështetjen, fuqizimin dhe organizimin e fëmijëve në kuadër të saj.

Kush e financon Projektin për të drejtat e fëmijëve pakicë në Kosovë dhe sa i rëndësishëm është ?

Ibrahim Krusha: Projektin nuk e përjashton mundësinë e përfshirjes së të gjithë fëmijëve të cilët janë pjesë e Asamblesë ku bëjmë pjesë 35 fëmijë të të gjitha komuniteteve. Themelimi i Asamblesë së fëmijëve është një hap drejt integritetit dhe përfshirjes së fëmijëve në vendimarrje që kanë të bëjnë me çështjet dhe interesat e tyre.

Sa do të zgjasë Projektin dhe si lindi idea për një Projekt të tillë?

Ibrahim Krusha: Projektin do të zgjas tri vjet. Ky është viti i dytë i implementimit të tij.

Paraprakisht kemi biseduar me donatorë të ndryshëm, njëri prej të cilëve ishte Organizata "Save the Children" me të cilin jemi në partneritet 11 vjet. Të gjitha Projektet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në bashkërisht i

implementojmë. Ne kemi biseduar si t'i përfshijmë të gjithë fëmijët që të kenë një pikënisje ku mund të mbledhen dhe të diskutojnë për të drejtat e tyre si dhe për realizimin e tyre. Idea ka qenë e përbashkët por iniciativa ka qenë e jona. Projektin së pari kemi filluar t'a implementojmë në komunën e Pejës në vitin 2009. Pas Organizatës "Save the children", Projektin e kanë mbështetur edhe Kuvendi Komunal-NJDNJ dhe Zyra për Barazi Gjinore si dhe Drejtoria Komonale e Arsimit, të cilët i falenderoj publikisht.

Çka prisni nga Asambleja e fëmijëve të Prizrenit?

Ibrahim Krusha: Formalisht, Asambleja e fëmijëve është duke funksionuar në Pejë, Gjakovë dhe Gjilan, ndërkaq e kemi themeluar edhe në Prizren. Nga këto Asamble ne presim që fëmijët vet t'i ngrisin çështjet që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave të tyre, sepse ata janë më afër problemit dhe ofrojnë zgjidhjen e tyre me ndihmën e Institucioneve.

Cilat janë trainimet për Asamblen e fëmijëve në Komunën e Prizrenit?

1. Trainimet për të Drejtat e fëmijëve;
2. Avokim për të Drejtat e fëmijëve;
3. Dizajnimet e Projekt-propozimeve;
4. Komunikimi ndërmjet bashkëmoshatarëve;

Pas trainimeve, fëmijët do të dalin me Projekt-propozime që do t'ë mbështeten nga "OJQ "Iniciativa 6".

Ne kemi menduar se fëmijët duhet të organizohen dhe të takohen me kryetarët e shkollave, Këshillat e shkollave dhe të

RADIO EMISIONI KUSHTUAR THEMELIMIT TË ASAMBLESË SË FËMIJËVE NË KOMUNËN E PRIZRENIT

**Në emision morën pjesë:
Mybexhel Zhuri, Koordinatorë e Njësive Komunale për të Drejtat e Njeriut,
Ibrahim Krusha "OJQ "Iniciativa 6",
Ideal Sallauka, Ramë Krusha dhe Bleranda Karavidaj,
Asambleistët e fëmijëve të Komunës së Prizrenit**

shpërndajnë informacionin se është formuar Asambleja e fëmijëve që ka të bëjë me mbrojtjen e interesave të fëmijëve.

Si do të ndikoj Projekti për ngritjen e kapaciteteve të Asamblesë së fëmijëve?

Ibrahim Krusha: Me marjen e njohurive fëmijët do të kenë mundësi të njohin të drejtat e tyre, t'i realizojnë ato, të kenë përgjegjësi dhe të avokojnë për zgjedhjet e problemeve të tyre në mënyrë institucionale. Presim që fëmijët të dalin me ide të reja duke mbajtur debate dhe takime me drejtorët e shkollave rreth ndarjes së buxhetit të shkollave, shpenzimit të buxhetit për inventarin e shkollës etj. Gjithashtu ata do të informojnë nxënësit sa shërbime ofron Qendra për Punë Sociale etj.

Ç'është Asambleja e fëmijëve?

Ideal Sallauka: Asambleja e fëmijëve është një organ i cili përbëhet prej 35 nxënësve të komunave të Prizrenit. Në Asamble kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë fëmijët nga klasa e VI-të deri të klasa e IX-të e shkollave fillore të Kosovës. Delegimi i nxënësve bëhet në bazë të numrit të nxënësve që ka shkolla - në çdo 500 nxënës 1 nxënës delegohet.

Cili është roli i Asamblesë së fëmijëve?

Ramë Krusha: Roli i Asamblesë së fëmijëve të Prizrenit është të përfaqësojnë interesat e fëmijëve duke kontaktuar me të gjithë fëmijët e shkollave që të identifikohen problemet dhe me institucionet arsimore të ofrojnë zgjidhjen e tyre.

Cilët janë anëtarët e Asamblesë së fëmijëve të Prizrenit?

Bleranda Karavidaj: Janë fëmijët e komuniteteve multietnike: turq, boshnjak, rom dhe fëmijët të komuniteteve të tjera pakicë.

A kanë përcjellë Asambleistët e fëmijëve trainime për të Drejtat e Njeriut?

Ideal Sallauka: Deri më tani janë mbajtur disa trainime:

1. Trainimi për të Drejtat e fëmijëve /Gjakovë/;
2. "Stop diskriminimit të fëmijëve";
3. "Shkathtësia sociale";
4. "Pjesëmarrja në vendimmarje";
4. Avokimi;
5. Dizajni i Projektit;

Çfarë porosi keni nga trainimet?

Ramë Krusha: Fëmiju i diskriminuar në çdo aspekt duhet të ngrisë zërin kundër dhunës.

Me çfarë probleme ballafaqohen fëmijët?

Ramë Krusha: 1. Diskriminimi i fëmijëve nga të rriturit; 2. Një numër i fëmijëve kërkojnë lëmshë, prandaj ne do të shqyrtojmë rastin e tyre dhe do të lajmërojmë institucionet përkatëse për të eliminuar këtë fenomen të keq.

Bleranda Karavidaj: Konventa për të drejtat e fëmijëve parasheh të drejta të barabarta për fëmijë, njëkohësisht obligime dhe përgjegjësi për me i'u përmbajtë Konventës.

CICERONI KULTUROR & FILMAT, CEREMONITË

CICERONI KULTUROR

6. II. 2014, Ekspozita e fotografisë në kuadër të Projektit “Bota ime-po i tejkalojmë pengesat”, Qendra Kulturore “Yunus Emre”, Prizren /Organizata e Personave me Distrofi Muskulare e Kosovë-Qendra Prizren-OPDMK/;

09-12. II. 2014, Ekspozita e fotografisë së autoreve: Sibel Sumuç dhe Elmedina Arapi “Emri i dhunës është gruaja” /Shtëpia e Kulturës “Xhamajli Berisha”, Prizren/;

23.IV.2014, Panairi i prodhimeve vendore dhe i artizanateve, Shoqata e Biznesmenëve dhe Zejtareve të Prizrenit “Esnaf”/Sheshi “Arasta”, Prizren/;

Ekspozita artistike e autores Ater Koro /Qendra Kulturore “Yunus Emre”, Prizren/;

11. IV. 2014, Filmi “Iron jawed angels”, Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës- RrGGK:/Kinemaja në Qendrën për Kulturë dhe Zhvillim “Europa”, Prizren/;

3-5.V. 2014, Panairi për nder të festës së Shëngjergjit, OJQ “Femra për Femrat me Aftësi të Kufizuara-FFAK, Prizren;

5.V.2014, Manifestimi për nder të festës së Shëngjergjit /Varrezat e vjetra myslimane të qytetit, Prizren/;

27.V-1.VI.2014, Java e Distrofisë Muskulare, OPDMK, Prizren;

30.V.2014, Manifestimi për nder të 1 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, “Sheshi Shadërvan”/Kuvendi Komunal, Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Zyra e Barazisë Gjinore, Prizren/;

10. VI. 2014, Manifestimi për nder të 136 vjetorit të themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Kompleksi Monumental i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit;

12-14.VI.2014, Panairi i veshjeve kombëtare tradicionale të trojeve shqiptare dhe artizanateve, Muzeu i hapur Arkeologjik.

FILMAT, CEREMONITË

FILMI “IRON JAWED ANGELS”

Me datën 11.IV.2014 në sallën e kinemasë së Qendrës për Kulturë dhe Zhvillim “Europa” u shfaqë filmi “Iron Jawed Angels” i cili bën fjalë për avokimin e grave në SHBA në vitin 1910 për të drejtat e grave për të votuar. Filmin e ndoqën anëtarët e OJQ-ve që veprojnë në Prizren, zyrtarët dhe Asambleistët e Kuvendit Komunal etj. Shfaqjen e filmit në Prizren e mundësoi Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës /RrGGK/.

FILMAT DOKUMENTARË TË BASHKIMIT EUROPEAN

Në muajin prill 2014, me organizimin e OJQ-së “Dora-Dorës”, u shfaqën disa filma dokumentarë të Bashkimit European për OJQ-të e grave që mirren me çështje gjinore dhe studentet

Filmat bënin fjalë për gjendjen aktuale në Kosovë, të drejtat e grave, të drejtat autoriale të krijuesve kosovarë etj.

CEREMONIA E SHPËRBLIMEVE PËR LLOGO TË RAJONIT JUGOR TË KOSOVËS

Më 17.IV.2014, në Qendrën për Kulturë dhe Zhvillim “Europa”, u mbajtë ceremonia e ndarjes së shpërblimeve për llogo rajonale me motive të trashëgimisë, e organizuar me shkolla të Rajonit Jugor të Kosovës. Ceremonia është pjesë e Programit të Përbashkët të Bashkimit European /Këshillit të Europës “Përkrahje për promovimin e diversitetit kulturor”/, me qëllim të promovimit të Rajonit Jugor të Kosovës. Ceremoninë e organizoi OJQ “Ec ma ndryshe” e cila është implementuese e Projektit. Në Foaje u ekspozuan punimet artizanale të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe punimet e filigranit të ndërrmarjes private “Filigran”, Prizren.

FAQJA KULTURORE

SIBEL SUMUÇ & ELMEDINA ARAPI “EMRI I DHUNËS ËSHTË GRUAJA” /EKSPOZITË E FOTOGRAFISË/

Prej datës 09-12.II.2014, u hap ekspozita e fotografive të dy autoreve: Sibel Sumuç dhe Elmedina Arapi “Emri i dhunës është gruaja”.

Me anë të fotografive artistike, ekspozita trajtoi dhunën në familje, sidomos ndaj gruas. Ekspozita u hap në Shtëpinë e Kulturës “Xhemajli Berisha” në Prizren.

PANAIRI I PRODHIMEVE VENDORE DHE I ARTIZANATEVE

Me datën 23.IV.2014, Shoqata e Biznesmenëve dhe Zejtarëve të Prizrenit “Esnaf” organizoi Panairin e prodhimeve vendore dhe të artizanateve për nder të inaugurimit të oborrit të restauruar të xhamisë së Sinan Pashës në Prizren.

Në Panair u ekspozuan veshjet kombëtare të vajzave, bizhuteri, qeleshe, filigran, vazo me lule të punuara prej sapuni, suvenire të punuara prej gurëve të vegjël dhe ushqime.

Panairi u hap në sheshin “Arasta” pranë Urës së Gurit dhe qëndroi i hapur 2 ditë.

Ekspozuan:

Qendra tregtare “Abi” Center, mishtorja “Shantiri”, qebaptorja “Hyska”, Shpresa Makasqiu /Shoqata e Zejtarëve dhe e Afaristëve e Prizrenit/, Ater Koro, Shenaj Buza dhe Sejlan Groshta /Shoqata e Biznesmenëve dhe Zejtarëve “Esnaf”/ etj.



PANAIRI I VESHJEVE KOMBËTARE TRADICIONALE TË TROJEVE SHQIPTARE DHE ARTIZANATEVE

Për nder të shënimit të Ditës së Çlirimit, në Prizren, prej datës 12-14.VI.2014, u hap Panairi i veshjeve kombëtare tradicionale të trojeve shqiptare dhe artizanateve. Panairi u hap në Muzeun e hapur Arkeologjik. Panairin e organizoi Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik pranë Kuvendit Komunal të Prizrenit.

Tre ditë u ekspozuan veshjet kombëtare, prodhimet zejtare dhe artizanale, si dhe materiale promovuese për zhvillimin e turizmit shqiptar /libra, katalogje, fletushka, guida turistike/.

Në ditën e parë, pos Panairit, në Kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u mbajtë Defileu i veshjeve tradicionale dhe koncerti i Ansamblit “Lidhja e Prizrenit”. Ndërkaq në restaurant “Ambienti” u mbajtë Seminari “Etnografia dhe Kostumet Kombëtare”. Referuan: Shpresa Siqeca /Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore, Prizren/, Kreshnik Belegu /Qendra për Trashëgimi Kulturore, Elbasan/, Edlira Sulaj /”Tradita Popullore Edlira”, Vlorë&Tiranë/ dhe Gjon Dugilaj /Shkodër/.

Në ditën e dytë, pos Panairit, u mbajtë koncerti i Ansamblit folklorik “Malësori”, Gjonaj, rajoni i Hasit të Prizrenit.


Në ditën e tretë, pas përfundimit të Panairit, u shpërndanë mirënjohjet për pjesëmarrësit.

Pjesëmarrësit në Panair:

Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik pranë Kuvendit Komunal, Prizren, Ndërmarrjet private: “Filigran” dhe “Arta”, Prizren; Ater Koro, Gentiana Makasqiu, Shoqata e Zejtarëve dhe e Afaristëve të Prizrenit, Restaurant “Tradita”, Shkodër, Rabie Spaho, Elbasan, Mimoza Galla “Shoqata e Grave me probleme sociale”, Pogradec, Antoneta Tafka, Korçë, Shoqata e Biznesmenëve dhe Zejtarëve “Esnaf”, Prizren.

Panairi dhe manifestimet përcjellëse u zhvilluan me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira me qytetet nga hapësira mbarëshqiptare që do të jenë padyshim një shtytje për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit shqiptar.

**MODEL I ENDUR NË VEK,
PRIZREN**



Një katror-një gojë e endur në vek


- 1 Ngjyrë e gjelbër;**
- 2 Ngjyrë e bardhë;**
- 3 Ngjyrë e zezë;**
- 4. Ngjyrë e gjelbër e qelët;**



Antigona Shestan dhe Resmija Rrahmani, udhëheqëset e Organizatës së Personave me Distrofi Muskulare të Kosovës, Qendra në Prizren



Foto nga Ekspozita e Organizatës së Personave me Distrofi Muskulare të Kosovës, Qendra në Prizren, 6.II.2014, Prizren



Model i endur në vek, Prizren

Java e Distrofisë Muskulare, OPDMK /27.V.-1.VI.2014, Prizren/



Shtëpia e Shuaip Pashës, Prizren



Trashëgimia natyrore

